03-200-75226
Data/Datum/Tarih 18.07.2024
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E GJILANIT**

**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

| | |
|---|---|
| Data/Date/Datum: | 18.07.2024 |
| Për/To/Za: | Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) |
| Nga/From/Od: | Arbenita Sopi Haziri – Kryesuese e Komisionit për hartimin e Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit |
| Përmes/Through/Preko: | Alban Hyseni - Komuna e Gjilanit |
| Lënda/Subject/Tema: | Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2023 |

Të nderuar/a,

Bazuar në Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për vitin 2023, brenda afatit të përcaktuar sipas Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, neni 23, paragrafi 5, ju lutem gjeni të bashkangjitur Planin e Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjilanit për Vitin 2023, të përgatitur nga Komisioni i themeluar sipas Vendimit me nr.02/403, të dt.14.03.2024.

Me respekt,

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**

**KOMUNA E GJILANIT**
**OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI**

**ZYRA E KRYETARIT**
**KANCELARIJA PRESEDNIKA/MAYOR'S OFFICE/BASKAN OFISI**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJILANIT - OŠTINA GNJILANE - GILAN BELEDIYE
Nr/Br/No. 03-200-75226
Data/Datum/Tarih 18.07.2024
GJILAN - GNJILANE - GILAN

**PËR:**
Zyra Kombëtare e Auditimit

**NGA:**
Alban Hyseni
Kryetar i Komunës së Gjilanit

**LËNDA:**
Plani i Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës për Vitin 2023

Gjilan,
Korrik, 2024

| Nr. | Gjetja/Çështja | Rekomandimi | Veprimet e planifikuara | Zyrtari\ët përgjegjës | Data e planifikimit të zbatimit të rekomandimit |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | B1-Keqklasifikimi i shpenzimeve | Kryetari duhet të sigurojë që në koordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa apo ridestinimi i transaksioneve të bëhet sipas kategorive ekonomike adekuate. | 1.Kryetari do të siguroj planifikimin e fondeve për obligimet sipas kategorive ekonomike adekuate.<br>2. Kryetari në koordinim me Ministrin e Financave, Punës dhe Transfereve do të siguroj që shpenzimet të bëhen nga kategoritë ekonomike adekuate. | Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 2 | B2-Mospërdorimi i programit të e-pasurisë dhe mungesë e regjistrave për pasurinë nën 1,000 euro | Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë jo kapitale në sistemin e-pasurisë me qëllim të prezantimit të plotë dhe të saktë të tyre në PVF. | 1.Do të themelohet komisioni për vlerësim dhe do të bëhet vlerësimi i pasurisë.<br>2.Do të futen të gjitha të dhënat në programin e-pasuria. | Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Drejtoria e Administratës, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Arsimit | TM3, TM4 |
| 3 | A1 – Pagesa e projekteve në kundërshtim me ligjin e buxhetit | Kryetari duhet të sigurojë që të përforcohen kontrollet dhe të rritet përgjegjësia në procesin e ndarjes së fondeve për projektet kapitale duke i dhënë prioritet projekteve të papërfunduara nga vitet paraprake. | Do të sigurohet monitorimi i ndarjes së fondeve për projekte kapitale sipas prioriteteve. | Të gjitha drejtoritë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa | TM3 |
| 4 | A2 – Anashkalimi i proceduarve të prokurimit | Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar kërkesat e kornizës ligjore për procedurat e prokurimit për të gjitha | Të gjitha inicimet e projekteve në të ardhmen do të bëhen përmes | Të gjitha drejtoritë<br>Zyra e Prokurimit | TM3, TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | punët të cilat janë objekt i prokurimit publik. | procedurave të prokurimit | | |
| 5 | B3 – Mangësi lidhur me marrëveshjet për shërbime të veçanta | Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e angazhimit të personave me marrëveshje për shërbime të veçanta, të respekton kriteret sipas legjislacionit përkatës. | Do të plotësohen pozitat përmes procedurave të rregullta të rekrutimit dhe prokurimit | Zyra e Kryetarit | TM4-2024, TM1-2025 |
| 6 | B4 – Mos verifikimi i plotë i pronave komunale | Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë. | 1.Zhvillimi i procedurave të rekrutimit të stafit për evidentimin e pronës së paluajtshme. | Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Zyra e Personelit dhe Zyra e Kryetarit | TM3, TM4-2024 dhe TM1-2025 |
| 7 | B5 – Vonesa në kryerjen e obligimeve të papaguara dhe shpenzimet gjyqësore/përmbarimore | Kryetari duhet të përmirësoj menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen në kohe dhe brenda afatit prej 30 ditëve, në mënyrë që ti shmanget | 1.Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, këtë vit ka hartuar elaboratin e shpronësimit për qarkoren e vjetër sipas planit | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | shpenzimeve shtesë të interesit dhe kamatës. | zhvillimor urban dhe e ka dorëzuar në ministrinë e linjës për kontroll me qëllim të bëhet kërkesa që problemet e shpronësimit në këtë rrugë të trajtohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës, pasi që shumica e lëndëve përmbarimore janë nga kjo rrugë e cila është në funksion nga viti 2000.<br>2.Për vitin 2024 janë planifikuar 500,000.00 Euro për shpronësim, llogaritur dhe shumën në 2 vitet paraprake, shuma e vlerës së mjeteve | ——<br>—— | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | dedikuar për shpronësim është mbi 10,000,000.00 Euro.<br>3. Në bazë të mundësive buxhetore do të kryhen obligimet brenda afateve ligjore | — | |
| 8 | B6 – Mos respektimi i hapave për procedimin e pagesave | Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve që zyra e prokurimit do të ndjek të gjithë hapat për procedimin e pagesave të përcaktuara me Rregullën Financiare për shpenzimin e parave publike | 1.Respektimi më rigoroz i hapave për procedim të pagesave.<br>2.Njoftimi i menaxherëve të kontratave dhe zyrtarëve financiar që pa urdhër blerje mos të inicohen punët. | Zyra e Prokurimit<br>— | TM3 |
| 9 | A3 – Vonesa në vlerësimin e tenderëve | Kryetari duhet të siguroj forcimin e kontrollit në mënyrë që | 1.Komisionet do të njoftohen për afatin kohor | Zyra e Prokurimit | TM3 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | komisioni vlerësues të kryej vlerësimin e tenderëve brenda afatit 30 ditorë. | të vlerësimit të tenderëve.<br><br>2.Në raste të vonesave do të njoftohet kryetari për ndërmarrjen e veprimeve për respektim të afateve. | — | |
| 10 | B7 – Regjistrat e menaxhimit të kontratave jo përmes platformës së e-prokurimit | Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik. | 1.Do të mbahet trajnimi për menaxherët e kontratave për përdorimin e platformës elektronike dhe futjen e të dhënave në të.<br><br>2. Do të sigurohet që secili menaxher i kontratave do të mbajë dhe arkivojë të dhënat në | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe menaxherët e kontratave<br><br>— | TM3 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | sistemin elektronik. | | |
| 11 | B8 – Dobësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme | Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme. | 1.Sektori i tatimit në pronë në përputhje me hyrjen në fuqi të manualit për procedurat e mbledhjes së detyrueshme do të merr hapa të mëtutjeshme për inkasimin e llogarive të arkëtueshme.<br><br>2.Shpallje e njoftimit për thirrje të borxhlinjve të tatimit në pronë për pagesën e borxhit në këste.<br><br>3.Organizim i takimit me top dhjetë borxhlinjtë e tatimit në pronë me Kryetarin, drejtoreshën e buxhetit dhe financave dhe | Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit | TM3 dhe TM4 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | shefen e tatimit në pronë, për të ftuar borxhlinjtë për kryerjen e obligimeve ndaj komunës. | | |

Datë: 18.07.2024

Gjilan

Kryetari i Komunës:

Alban Hysemi